



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-13063 dt. 13/03/2024

## PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **22.02.2024**, ora **10:00**

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

### Rend Dite:

- Znj. Kosovare Halilaj Karaxha, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Drenas, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" duke zëvendësuar znj. Albulena Saliuku e cila lirohet nga detyra e anëtares së Kuvendit Komunal.**
- Procesverbal i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, i mbajtur me datën 22.01.2024.**
- Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit nr. 02-353/01-5031 dt. 29.01.2024. për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.**
- Propozim Vendim për subvencionimin e nënave lehona.**
- Propozim Vendim për përcaktimin e kompenzimit të anëtarëve të komisionit komunal aksionar për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A.**
- Të Ndryshme.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** pasi përshëndeti të pranishmit, kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** sapo e përfundova një takim të gjatë me bordin edhe menaxhmentin e stacionit të autobusëve, ata kanë me pas kërkesa për investime për me certifiku ose licencu, stacioni ka nevojë edhe shumë veprime mi marr na siq është ndërtimi i laurës, i banjove, i zyrave, i rrethojave e tjera unë ju kërkova për shkak se mos me u shty edhe një muaj sepse ata i kanë do procedura duhet me mbajt mbledhje bordi i kanë dy shkallë i kanë me ba kërkesën për me pru në rend të ditës për me e mbështet stacionin e autobusëve jo me pare po me investime në bazë të kërkesave të tyre, ka me qen pjes e rendit të ditës edhe

kjo unë besoj që është e akceptushme prej asambleistave sepse është nevoj e domosdoshme ata njëherpër njëher nuk kan të hyra dikun 2000 e diqka euro prej peronizimit ju e dini që i kemi penalizu aty se i kemi fal këto taksa disa her ma nuk ka sepse nuk kem mundësi ma me i fal sepse dikush duhet me ja dhën pagat, nuk marrin paga as prej buxhetit që e kemi nda buxhetit themeltar as prej këtyre investimeve paga as mëditje ata nuk kan se nuk kem të drejt as na me ba po as ata nuk e bajn

**Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Kryesuesi i Komunës Milaim Hajdari** hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Znj Kosovare Halilaj Karaxha emrohet anëtare e Kuvendit Komunal Drenas nga subjekti politik " Partia Demokratike e Kosovës "duke zëvnëdusuar znj. Albulena Saliuku e cila lirohet nga detyra e anëtares së Kuvendit Komunal.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Procesverbal i mbledhjes të Komitetit për Politik e Financa, i mbajtur me datën 22.01.2024.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit nr. 02-353/01-5031 dt. 29.01.2024. për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.**

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**- kur e kemi kalu në mbledhjen e kalume gjithqka e kemi pas në rregull unë ju kom thën që nëse nuk e keni ndërmend me i ndërtu çerdhet mos na detyroni me ba procedura, ata kan thën jo nuk ka keni dërgu hartën na e kem në plan zhvillimor edhe në hart zonale gjithqka e kem në rregull tash ja dërgojm edhe një hart shtes me u cekë që është për shërbime arsimore dhe e kemi cek që është në tok ndërtimore domethan ka mungu kjo.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për subvencionimin e nënave lehona.**

**Florentin Elezi Veliu-** mirë që ka ardh propozimi vendimi për subvencioniumin e nënave lehona po deshta me pyt pse nuk është edhe propozim vendimi për subvencionimin e fëmijëve në qerdhe private

**Muhamet Gjoka-** propozim vendimi për subvencionimin e fëmijëve në qerdheve e don një analiz, ne kemi kërku prej Ministris së Arsimit prej sistemit “Smia” numrin e fëmijëve që janë në qerdhe private mirëpo i kemi marr veq një numër të vogël vetem dy qerdhe i kan raportu është një pjes që nuk j i menagjojm ne direkt duhet në forma tjera me siguru numrin e fëmiojëve sa është edhe e don një analiz sepse e don një implementim jo i let ka me qen bukur i komplikum duhet me i mendu të gjitha opcionet që me u menagju në mënyren ma të mirë

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** na e bëjm vendimin kushdo që bën kërkesë e plotëson dokumentacionin i bjen pagat edhe ne e shohim se kand kem të drejt me vendim me subvencionim e kënd jo

**Muhamet Gjoka-** për planifikim të buxhetit na duhet paraprakisht me dit sa është numri i fmive potencialisht sa mujm me i pas, ata që i plotësojn kriteret e bëjn kërkesën

**Kryetari I Komunës Ramiz Lladrov-** na e bëjm një shpallje publike ose një thirrje me apliku për subvencionim edhe e shtyjm në kët mbledhje nëse është nevoja edhe e dim kush ka apliku kush e dim shumën edhe e qojm në kuvend

**Florentina Elezi Veliu-** pajtohem ashtu qysh po thot kryetari po perderi sa ti pe sheh që në qytetin tënd te qytetart e tu është ka ndodh një parregullësi unë mendoj që na bashkarisht mesi jem qytetar të drenasit pa dallim partie që me ju ba presion qerdheve që me u regjistru secili fëmijë masandej do të kemi shumë parregullësi duke e fsheh numrin e fëmijëve, propozimin e kom ba qe me i qit në vij qerdhet sepse është jasht normales me kan të regjistruar vetëm 80 fëmijë, 80 fëmijë i ka vetëm një qerdhe

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-** pajtohem me ty Florentina po nuk po mundem me besu që një qerdhe nuk i ka regjistru ose nuk i ka deklarë numrin e fëmijëve sepse në qerdhe mundet me ndodh gjithëqka dhe pronari e din që denohet

**Muhamet Gjoka-** regjistrimin për nevoja të brendshme i regjistrojn sepse kan edhe kontrat po kur vjen puna te deklarimi në Ministri me qellim me ju ik tatimeve ndoshta është veq paragjykim po realisht është ajo. Inspektoriati ka vepru pasi edhe unë ju kom shkrujt kan qen në dy raste kan ba një raport që kan qen në rregull. Kur ka ardh propozimi e kemi analizu edhe e kom dit që në implementim nuk ka me qen sikur për lehonat ky propozim vendim ka me qen ma i vështir i menagjushëm në praktik për shkak se mundet me pas edhe kundër efekt e dim që shumë punëtor nuk janë paizer me kontrata ndoshta i kan të hyrat 1000 euro këtu e bjen dëshmin që është me 400 euro dikush që është korrekt aj e deklarë edhe e njeh se ne jemi shoqri rreth i vogël edhe njihemi me njëri tjetrin edhe mendojm që komuna e ka privilegju e ka liru, këto duhet me i analizu për ata ka marr ma shumë kohë nuk ka me kan shumë e thjesht e komi diskutu edhe fillimisht është mirë me i parapa të gjitha efektet që mundet me i shkakto ky propozim në mënyr që me u mnenagju sa ma mirë që është e mundshme

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** ajo që tha drejtori i Arsimit kuvendi ka marr vendim mjetet duhet me qenë, tjetra që tha kryetari me bo thirrjen për regjistrim me u

lajmru kjo ti demaskon qerdhet ata detyrimisht kur të vjen prindi të aplikoj atëher aj nuk ka mundësi tjetër pa e deklaruar që e ka atë fëmijë, sa i përket atyre që marrin pagë të madhe se deklarohen na duhet me ju referu atyre që marrin paga prej sistemit publik. Kjo mbetet tutje me u analizu edhe me ardh si propozim vendim i veçant për qerdhe. Sa i përket lehonave duhet me qenë një vendim që i përfshin në aspektin procedural duhet me qen i qart se qysh bëhet kërkesa, e bëjn kërkesën në komun me dokumentacionin e nevojshëm edhe duhet me ju bart mjetet

Meqë nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të komisionit komunal aksionar për ndërmarrjen publike lokale “Stacioni i Autobusëve “ SH.A.**


**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** te kjo pikë para se të diskutojm që është pikë e njejt me atë Kompanin Rajonale Pastrimi Ministria na e ka kthy sëpaku MAPL-ja e ka dërgu këtë propozim vendimin që e kemi dërgu na e ka dërgu në Ministrin e Punëve të Brendshme, kjo ka thën se ne nuk kemi organ kompetent për mi vlersu zyrtarët publik, duhet edhe njëher me bisedu me MAPL-n a e kan dërgu ata gabimisht apo ku duhet mu adresu. Ky propozim vendim është është përafërsisht i njejt.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Të Ndryshme.**

**Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:20 min .**

Procesmbajtëse:



Indira Olluri Thaçi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Milaim Hajdari